

Procesi i fertilitetit – Me sistem drejt suksesit

Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe aksioner i Austria Praemix shpk.

Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka



Pjelloria, në fushën e blegtorisë, është një ndër temat më të diskutuara dhe në mbarështimin e gjedhit është vendimtare për suksesin ekonomik. Në shumë ndërmarrje, procesi i fertilizimit përkufizohet vetëm në termat e zbulimit të afshit dhe të ndërzimit. Si mund të zhvillohet një pjellori e mirë, tregohet më poshtë.

Lopët në periudhën e tharjes

Periudha e tharjes është faza në të cilën çdo lopë mund të rimarrë veten. Ndodhin shumë ndryshime hormonale, që janë të nevojshme për procesin e tharjes dhe hyrjes në lakcionin e ri. Pra, në këtë fazë do të gjenerohen rezervat dhe do të rigjenerohen indet e gjirit. Veçanërisht, mëlçia si nje organ qëndror metabolik përdoret në këtë fazë si një depozituese. Elementët gjurmë, të tilla, si zinku dhe bakri mund të asimilohen shumë mirë në këtë fazë. Po kështu, është e rëndësishme, që kafshët në këtë periudhë të furnizohen me sasi të mjaftueshme seleni dhe

vitamin E, të cilat forcojnë sistemin e tyre imunitar. Një mungese e tyre shpesh çon në problemin e mbetjes së placentës dhe në viça të dobët.

Në lidhje me bilancin e mineraleve edhe elementëve kalcium, kalium, fosfor dhe magnez, i duhet kushtuar vëmendje. Një disbalancë e tyre mund të shkaktojë mungesë të kalciumi pas lindjes, që në rastin më të keq manifestohet me ethet klinike të qumështit. Por "klinikisht" mungesa e kalciumit në javët e para të laktacionit manifestohet me oreks të reduktuar, lindje të vonuara dhe vështirësi në daljen placentës.

Gjatë furnizimit me energji, duhet të kemi parasysh se konsumimi i ushqimit nga kafshët me barsmëri të lartë të mos ulet. Për mbajtjen, rritjen e viçit dhe formimi e fundit të gjendrës së qumështit, duhet të ketë në dispozicion ushqim të pasur me energji. Në rast të kundërt do të shfaqen çrregullime metabolike në formën e ketozës, të cilat mund të forcojnë inflamacionin e mitrës, placentës dhe ethet e qumështit.

Përveç arsyeve të lartëpërmendura, me rëndësi të madhe janë edhe disa faktorë si: mbajtja në një boks të shtruar me kashtë, ushqimi i mirëlllogaritur për lopët në periudhën e tharjes. Siç u përmend tashmë, duhet të përshtatet sasia e lëndëve minerale, elementët gjurmë dhe përmbajtja e energjisë për të arritur një lindje pa probleme dhe një periudhë paslindjeje të qetë. Nëse do të punohet saktë, atëherë përveç rendimentit të mirë në laktacionet e ardhshme, do të bëhet një hap i rëndësishëm në drejtim të pjellorisë.

Procesi i pjelljes

Gjatë procesit të pjelljes janë të nevojshme: qetësia, durimi, vëzhgimi i mirë dhe një mjedis me higjenë të lartë. Ndërhyrjet të parakohshme në shumë raste çojnë në lëndime të lindjes. Sidomos dëmtimet në zonën e qafës së mitrës shpesh nuk vihen re dhe janë përgjegjëse për tkurrjen (mbylljen) jo të duhur të mitrës. Kjo shpesh çon në infektimin e mitrës dhe në ulje të pjellorisë. Në përgjithësi, lopët dhe mëshqerrat duhet ti sjellin viçat e tyre vetë pa ndihmesë. Edhe zhvendosja e vicit, kokës apo e gjymtyrëve mund të korrigojen nga vetë lopët, nëse ato kanë në dispozicion një boks pjellje të madh në të cilin mund të ngrihen, rrotullohen dhe të bëjnë disa hapa lirshëm. Gjatë lëvizjeve të lopes, viçi mund të pozicionohet në vendin e duhur. Në shumë raste, viçi madje ia arrin vetë, që të drejtojë një këmbë drejt kanalit të lindjes.

Nëse është e nevojshme një ndërhyrje manuale, atëherë duhet bërë në një mjedis higjenik. Përdorimi i ujit të ngrohtë dhe sapunit për pastrimin e duarve dhe organeve riprodhuese është

kusht. Në përgjithësi, një person i dytë duhet të mbaj bishtin në një anë, për të shmangur ndotjen. Nëse është e nevojshme, bishti mund të fiksohet përpara qafës me një litar. Higjena e dobët në mënyrë të përsëritur çon në infeksione të mitrës, pasojë e së cilës është rrjedhja e papastër. Kjo, si dhe dëmtimet e qafës së mitrës të përmendura më sipër, kanë efekt negativ në pjellorinë në vazhdim.

Puerperium (ditët e para mbas pjelljes) - faza e mbaspjelljes

Periodha direkt mbas pjelljes përkufizohet si *puerperium* dhe është një fazë kritike përsa i përket shpeshtësisë së sëmundjes të lopëve. Ethet e qumështit, sjellja mbas lindjes, imflamacioni i gjirit, çrregullime metabolike janë ndër problemet kryesore në këtë fazë. Ato kanë një efekt negativ në pjellori. Ethet e qumështit dhe mbetjet e placentës, vijnë si rezultat i pastrimit të vonshëm të mitrës.

Ketoza ka një efekt negativ në pjekurinë e vezoreve. Vezoret duan rreth 70 ditë kohë për zhvillimin e tyre para procesit të ovulimit. Në një studim është treguar se acidet yndyrore të lira pasurojnë jo vetëm gjakun, por edhe lëngjet e vezoreve, të cilat sjellin rezultate të ulëta të fekondimit. Kështu janë edhe ketozat e hershme, të cilat mund të shfaqen menjëherë pas pjelljes, që lidhet direkt me një ndërzim problematik.

Prandaj, në këtë fazë, kontrolli i mirë metabolik është një mjet thelbësor për identifikimin në kohë të problemeve. Vetëm matja e trupave ketonik në qumësht, urinë apo gjak na jep informacion në lidhje me praninë e ketozës subklinike. Masë parandaluese mund të jetë edhe aplikimi i Bolusit (fosfor-kalcium), i cili stimulon pozitivisht metabolizmin në rumen. Për ndihmë të drejtpërdrejtë të ketozës, duhen përdorur produktet me propylene glycol, glicerinë apo propionate, të cilat jepen me ndihmën e aplikimit oral të lengshëm. Në fund i gjithë racioni ushqimor duhet parë imtësisht, ku mbi të gjitha i duhet kushtuar vëmendje jo vetëm përmbajtjes së energjisë së ushqimit, por edhe rritjes së sasisë së ushqimit. Ushqimi voluminoz, i shijshëm, përdorimi i melasës, ofrimi i ushqimit në grazhd dhe ushqyerje e njëtrajtshme, janë qasjet e mundshme që mund të çojnë në një konsum më të lartë të ushqimit.

14 ditë pas lindjes, lopët duhet të kenë përfunduar fazën e parë të pastrimit. Nëse pas tri javësh vihet re ende rrjedhje ose derdhje të qelbëzuara ose të bardha, duhet të bëhet ndërhyrja veterinare sa më shpejt të jetë e mundur, pasi kjo mund të çojë në një inflamacion kronik të mitrës.

Pamja e jashtëme të gënjen...

Megjithatë, jo në të gjitha kafshët mund të dallohet një rrjedhje e qelbëzuar. Në disa raste, qafa e mitrës është e mbyllur dhe kafsha duket në rregull nga ana e jashtme. Për këtë arsye, lopët duhet të ekzaminohen nga veterineri pas pjelljes. Zbulimi dhe trajtimi i hershëm i infeksioneve është më i suksesshëm sesa zbulimi i vonshëm dhe i përgatit kafshët për mbarështimin e ardhshëm.

Problemet e fertilitetit

Lopët e shëndetshme vijnë shpesh 3-4 javë pas lindjes për herë të parë në afsh. Edhe pse ky afsh është shumë herët për nderzim, duhet të shënohet në çdo rast. Gjithashtu, shkarkimi duhet të vëzhgohet me kujdes dhe të analizohet për mbetje. Kalendari i afsheve (kalendar tre javor) ose programet kompjuterike përkatëse mund të na ndihmojnë për të dalluar afshin e ardhshëm të lopëve (21 ditë më vonë).

Nëse kafshët nuk arrijnë në afsh brenda gjashtë javëve pas pjelljes ose mosvënia re e tij, atëherë duhet të bëhet përsëri një ekzaminim gjinekologjik. Diagnoza e veterinerit është e rëndësishme, jo vetëm për trajtimin e ardhshëm të infertilitetit, por edhe për të dalluar shkakun e mungesës së afshit dhe për t'i shmangur ato në të ardhmen.

Kështu, është vënë re shpesh rritja e shfaqjes së cisteve folikulare nga ketoza dhe humbje të rënda të peshës pas pjelljes.

Gjithashtu mangësi të natriumit (kripës) ose mungesa e beta-karoten (provitamina A), duhet të konsiderohen në problemet me kistet.

Megjithatë, pasja e vezoreve jo-funksionale, shkakton mungesë kronike të energjisë. Në këto raste, vetëm terapia hormonale të çon me sukses në përmirësimin e bilancit energjik.

Gabimisht fermerët shpesh diagnozën e "trupit të verdhë" e shohin si një sëmundje dhe veterineri i sjell kafshët në afsh me një injeksion. Megjithatë bëhet fjalë për gjedh të shëndetshme, afshi i të cilëve ishte i pranishëm, por nuk u zbulua nga fermerët. Kjo ndodh për shkak të afshit më të shkurtër në lopët me rendiment të lartë (nganjëherë më pak se 5 orë), problemet e thundrave, dysheme të rrëshqitshme ose edhe në një zbulim të dobët të afshit. Për të përmirësuar zbulimin e afshit mund të përdoren sisteme teknike me lëvizje dhe matja e ripertypjes. Në rastin më të thjeshtë mund të përdoren ngjitësat e afshit, të cilat ndryshojnë ngjyrën e tyre, kur kafsha hidhet.

Ndërzimi

Në cilën pikë, pas lindjes, duhet realizuar ndërzimi tek një lopë?

Ka një shumëllojshmëri pikëpamjesh, të cilat marrin në konsideratë të dy aspektet, atë mjekësor si dhe aspektin ekonomik. Në shumë ferma, është provuar shumë herë, shfrytëzimi i afshit të përshtatshëm. Pra, kafshët me afsh të qartë dhe rrjedhje të pastra edhe me rendiment të lartë (mbi 50 litër sasi ditore) mund të ndërzehen mbas ditës së 35-të të laktacionit. Shpesh intensiteti i afshit ulet ndjeshëm. Kjo e bën të vështirë për të arritur një sukses të mirë të mbarështimit.

Ndërzimi duhet të kryhet teknikisht në mënyrë korrekte. Doza e spermës duhet të shkrijë në ujë të ngrohtë për 10 sekonda në 38 °C dhe duhet ruajtur në një temperaturë konstante ambienti deri kur të sillet te ambienti i ndërzimit (tek lopa). Për këtë qëllim pistoleta e ndërzimit mund të transportohen në një "aparaturë ngrohës" ose të transportohet shumë afër me trupin e lopës që do ndërzohet. Gjatë inseminimit duhet punuar sa më pastër të jetë e mundur. Materiali biologjik duhet të ruhet pa dëmtuar qafën e mitrës në zonën përkatëse të trupit. Nga dëmtimet e mukozës mund të shkaktohen gjakderdhje dhe në këtë mënyrë ulen shanset për një fekundim të suksesshëm. Një gjakderdhje e lopës ose e mëshqerrës një deri në dy ditë mbas ndërzimit është një reagim që vërehet në 30% të tufës dhe nuk tregon nëse kafsha është ndërzyer ose jo.

Mbarsja

Si shumë fermerë e dinë nga përvoja, kafshë që pas inseminimit të fundit nuk kanë manifestuar shenja afshi, nuk janë domosdoshmërisht barëse. Për këtë arsye, kontrolli i parakohshëm i barsmërisë është një tregues i mirëmenaxhimit të pjellorisë.

Ajo që duhet të jetë e qartë është se qëllimi i kontrolleve është zbulimi më i hershëm i kafshëve jo barëse, në mënyrë që ato të trajtohen dhe të ndërzehen përsëri. Nëpërmjet makinave me ultratinguj kjo mund të bëhet që në ditën e 25 të ndërzimit. Edhe pse mbas ditës së 25-të mund të ngordhi fetusit dhe të kemi vdekje embrionale, kjo metodë ndihmon shumë për të evidentuar kafshët jo barëse për të mundësuar ndërzimin e përsëritur të tyre.

Megjithatë mbas çdo ekzaminimi të hershëm të barsmërisë, ne duhet të kryejmë një kontroll të mëvonshëm, rreth 60 ditë, për të identifikuar ndonjë abort. Në kuadër të kontrollit të dytë janë me

rëndësi mjetet me ultratinguj si dhe informacionet shtesë për përcaktimin e gjinisë ose dallimin e binjakëve.

Nga pikëpamja e pjellorisë së lopëve është e nevojshme vëzhgimi i “lopëve të sigurt për ndërzim”. Nëse këto kafshë kanë shenja të afshit ose tregojnë shkarkime të pazakonta vaginale, ato duhet detyrimisht të vizitohen nga veterineri. Ndoshta mund të ketë ndodhur një abort pa u vënë re ose mund të ketë pasur një infeksion të viçit në mitër. Nëse është e dobishme në raste të tilla për të ndërzyer kafshën përsëri, duhet të vendoset rast pas rasti dhe varet nga shumë faktorë, të tillë si prodhimi i qumështit dhe vlerat e rritjes. Synimi i kontrollit të dytë të barsmërisë mbi 60 ditë është për të zhdukur cdo dyshim mbi barsmërinë dhe për të mos kaluar në tharje lopë të cilat nuk janë të mbarsura.

Përfundim

Pjelloria e mirë është rezultat i punës së qëndrueshme, që kërkon kohë çdo ditë. Monitorimi i periudhave të ndryshme nga periudha e tharjes, lindjes dhe pas lindjes deri në periudhën e ndërzimit, janë aq të rëndësishme sa ai i vëzhgimi të afshit ose vetë ndërzimi. Kontrollat e rregullta tek veterineri pas lindjes, për teste të sterilitetit, janë element të rëndësishme në menaxhimin e mirë të pjellorisë. Puna mbi pjellorinë sa më sistematike dhe rutinë të jetë, aq më e suksesshme dhe afatgjatë do të jenë dhe do të sjellë sukses, gëzim dhe entuziazëm në punë!